



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.0.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të mirë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Prishtinës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri mbështetur nga Xhevat Seferi (Udhëheqës i ekipit), Ejup Simnica, Blerina Krasniqi dhe Shpresa Zenelaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	8
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak	12
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	13
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	28
6 Konkluzioni i përgjithshëm	29
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	31
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	33

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) për vitin 2012 për Komunën e Prishtinës. Ne falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i PVF për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF-të.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Vlerësimin nëse PVF-të paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë në të gjitha aspektet materiale;
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm, duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit; dhe
- Pajtueshmërinë e procedurave

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3 Opinioni i auditimit. Shtojca I i shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* ne dëshirojmë t'ua tërheqim vëmendjen në faktin se:

Në shënimin 32. gjendja e stoqeve të materialit zyrtar nuk ishte shpalosur plotësisht duke i nënvlerësuar mbi €101,000; dhe

Në shënimin 34 Llogaritë e arkëtueshme nuk janë paraqitur në vlerën e saktë, pasi nuk janë përfshirë llogaritë e arkëtueshme nga Licencat e veprimtarisë së bizneseve.

(SNISA 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes)

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pajtueshmërinë e procedurave të pagesave dhe pranimeve, si dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Është bërë një numër i përmirësimeve nga Menaxhmenti në vitin 2012, të cilat e kanë rritur rangun e procedurave dhe proceseve të kontrollit financiar, për shembull kanë përmirësuar regjistrimin e pasurive. Megjithatë, mbetet edhe më tutje hapësirë për përmirësime për të siguruar aplikim gjithëpërfshirës dhe konsistent të kontrolleve të duhura nëpër të gjitha aktivitetet e Komunës, me theks të veçantë në fushën e menaxhimit të kontratave. Dobësitë në detaje janë përshkruar më poshtë.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim ta mbështesin Komunën e Prishtinës në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne i kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se kërkohet theks shtesë në implementimin e rekomandimeve të auditimit për t'iu shmangur dobësive të vazhdueshme të kontrollit.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të Komunës së Prishtinës dhe të gjeturat tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit, si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e komunës janë si në vijim:

Pasqyrat vjetore financiare

- të sigurojë që të gjitha shpalosjet janë të plota dhe të përfshira në pasqyrat vjetore financiare në pajtueshmëri me kërkesat e parashtruara nga rregulloret e Thesarit dhe duhet të sigurojë që PVF të vitit 2013 në mënyrë formale të inkorporojnë shqyrtimin e draft llogarive të bëra nga menaxhmenti.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- të sigurojë që plani i veprimit ta përcaktojë qartë orarin për adresimin e rekomandimeve të ZAP-it me anëtarët e identifikuar llogaridhënës të stafit – dhe me fokus fillestar në fushat me rëndësi më të madhe;
- që në mënyrë sistematike t'i vlerësojë arsyet për nivelin e ekzekutimit të buxhetit që ka të bëjë me Investimet Kapitale në vitin 2012 dhe t'i përcaktojë opsionet

praktike për përmirësimin edhe të kësaj, por edhe të profilit të shpenzimeve gjatë tërë vitit. Kjo mund të përfshijë një vlerësim kritik të profileve të shpenzimeve të së kaluarës në këtë fushë dhe të konsiderohen barrierat dhe mundësitë në lidhje me realizimin e shpenzimeve kapitale të planifikuara;

- t'i rishikojë procedurat ekzistuese të mbledhjes së të hyrave nga tatimi në pronë dhe t'i konsideroj dhe implementoj opsionet në rritjen e shkallës së mbledhjes duke përfshirë këtu edhe aplikimin e mjeteve ligjore aty ku është e përshtatshme;
- t'i shqyrtojë procedurat ekzistuese dhe kontrollet që kanë për qëllim sigurimin e një shqyrtimi efektiv të ndërtimeve. Kjo duhet të përfshijë mekanizma për identifikimin e ndërtesave pa leje, monitorim efektiv të ndërtesave gjatë fazës së ndërtimit për të siguruar që lejet e ndërtimit janë të bashkangjitura;
- në të ardhmen kërkohet nxjerrja e një udhëzimi qendror për taksën e biznesit, të forcohen masat në mbledhjen e borxheve të mbetura nga kjo lloj takse dhe të identifikohen qartë të arkëtueshmet e pa mbledhura aty ku ekzistojnë dhe t'i shpalosin ato në PVF;
- të rishikojë projektin e unazës qendrore për të përcaktuar pse çështjet e pronësisë nuk janë identifikuar në fazën e planifikimit të projektit. Në rishikim duhet të ndërmerren procedurat ekzistuese të planifikimit të projektit për t'i shtuar kontrollet, për të siguruar që një çështje si kjo të mos ndodhë në të ardhmen;
- të shqyrtoj projektet e identifikuar nga ZAP-i dhe ta përcaktojë nivelin e ndërmarrë të monitorimit të kontratave dhe veprimet e ndërmarra kundër OE-së për të siguruar kompletimin apo adresimin e cilësisë së dobët të punës. Aty ku është e nevojshme, duhet të shtohen procedurat e monitorimit të kontratës për të siguruar që janë ndërmarrë me kohë veprime për t'i adresuar defektet e kontratës dhe klauzolat e dënimeve në kontratë duhet të aplikohen aty ku është relevante. Një theks i veçantë duhet t'i jepet cilësisë së specifikacioneve të vendosura në kontrata për të siguruar që pritet janë të qarta edhe për Komunën edhe për Operatorin Ekonomik;
- duhet të sigurojë grancione bankare valide në të gjitha kontratat relevante dhe të mos lejojë që Operatori Ekonomik ta fillojë punën para se të pranohet garancioni;
- duhet t'i forcojë kontrollet e brendshme në administratën komunale duke i qartësuar kërkesat për ruajtjen e dokumentacionit dhe duke siguruar që janë zbatuar opsionet e duhura të ruajtjes së tyre – duke përfshirë edhe të dhënat elektronike. Kontrollet mbikëqyrëse duhet të aplikohen për të siguruar plotësinë informatave që kërkohet të ruhen. Komuna duhet të hartoj një rregullore të brendshme për ruajtjen dhe klasifikimin e dokumenteve sipas Ligjit për Arkivat Shtetërore nr. 04-L-088-2012 Neni 17;
- duhet të zhvillojë politika dhe mekanizma gjithëpërfshirës për mbledhjen e taksave. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e një profili për vjetërsinë e borxheve

dhe të një vlerësimi rreth asaj se çka mund të arkëtohet. Në zhvillimin e planeve për të ngritur procedurat e mbledhjes, duhet t'i jepet rëndësi veprimeve të ndërmarra nga komunat tjera me mjete juridike, të cilat do të mund t'i mbështesin procedurat e mbledhjes ;

- duhet të sigurojë që departamenti i financave mban informata të plota dhe të sakta mbi regjistrimin dhe pagesën e faturave dhe ta bëjë shpalosjen e plotë të tyre në PVF; dhe

Sistemi i auditimit të brendshëm

- duhet të punojë me NJAB-në për të zhvilluar një plan të bazuar në rreziqe që do të ofronte siguri mbi të gjithat fushat e rëndësishme gjatë vitit 2013. Fushat ku janë dhënë rekomandimet duhet të shqyrtohen në mënyrë aktive nga menaxhmenti dhe duhet të zhvillohet një plan veprimi për t'i adresuar rekomandimet e dakorduara brenda një afati kohor relevant

Përgjigja nga Menaxhmenti

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut të auditimit për Komunën e Prishtinës. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet e brendshme menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjet për 9 mujorin aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe Menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Thesar.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF. Një numër i pikave në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar, për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithë përfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF-të ishin përgatitur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” përveç mungesës së informatave mbi stoqet e materialit shpenzues në sektorin e arsimit dhe atij të shëndetësisë dhe llogarive të arkëtueshme të taksës për leje pune të bizneseve. Këshillat e dhëna në lidhje me PVF 9 mujore janë adresuar nga Menaxhmenti.

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Në përputhje me RrF nr. 07/2011 dhe LMFPP nr. 03/ L - 048 ne kemi vërejtur se:

- PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MF;
- PVF janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ (Kryetari i Komunës) dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- PVF janë pranuar në gjuhën shqipe dhe serbe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF gjatë vitit 2012.

Edhe pse çështjet e ngritura gjatë auditimit të periudhës nëntë (9) mujore në memon tonë të datës 13.11.2012 në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti, PVF-të përfundimtare ishin jo të plota, si në vijim:

- Në Shënimin 32: Bilanci i stoqeve të mallrave, Komuna nuk i ka shpalosur stoqet e sektorit të arsimit në vlerë 50,908€, dhe sektorit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale në vlerë 50,415€; dhe
- Në shënimin 34: Llogaritë e arkëtueshme nga taksa nga liçencat e biznesit nuk janë shpalosur fare.

Të gjeturat dhe rekomandimet

1. Çështja - Porcesi i përgatitjes së PVF-ve - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura PVF-të nuk ishin subjekt i një niveli të duhur të shqyrtimit nga menaxhmenti para se të prezantohen në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Kjo rezultoj në një numër të lëshimeve që janë identifikuar në pasqyrat financiare, të cilat kanë mundur të theksohen nga shqyrtimi i Menaxhmentit.

Rreziku Mos shpalosja korrekte dhe e plotë e të gjitha llogarive në PVF shpie në keqkuptimin e pozitës financiare të komunës dhe rritë rrezikun që kërkesat statutores të mos përmbushen dhe/ose të kenë gabime. Kjo mund të ndikoj që të dhënat e kontabilitetit të mos jenë të mjaftueshme për t'i mbështetur proceset e vendimmarrjes së menaxhmentit dhe shqyrtimet buxhetore në aspekt më të gjerë.

Rekomandimi 1 Kryetari i Komunës duhet të sigurohet që të gjitha shpalosjet janë të plota dhe të përfshira në PVF në pajtueshmëri me kërkesat e rregulloreve të Thesarit dhe që plani i përgatitjes së PVF-ve për vitin 2013 formalisht adreson të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë lidhur me PVF-të duke përfshirë edhe adresimin e rekomandimeve të dhëna nga ZAP në vitin 2012, si dhe komentet e bëra në memon që lidhet me llogaritë 9 mujore të vitit 2013.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Ne kemi analizuar cilësinë e informatave të paraqitura në PVF. Informatat e paraqitura në PVF-të e vitit 2012 janë të plota dhe të sakta dhe janë bërë shpalosjet e duhura, pos atyre të dhëna në Seksionin 2.1 më lart.

Përshkrimi

Nuk janë kërkuar përshtatje financiare apo jo financiare të PVF-ve si rezultat i auditimit tonë. Shpjegimet dhe shpalosjet ekzistuese ishin adekuate, pos atyre të dhëna më Seksionin 2.1 më lart. Në këtë mënyrë, deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF kur draft PVF-të janë dorëzuar në Qeveri e japin një vlerësim të arsyeshëm, por jo të plotë të cilësisë së informatave të dhëna.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* ne dëshirojmë t'ua tërheqim vëmendjen në faktin se:

Në shënimin 32. gjendja e stoqeve të materialit zyrtar nuk ishte shpalosur plotësisht duke i nënvlerësuar mbi €101,000; dhe

Në shënimin 34 Llogaritë e arkëtueshme nuk janë paraqitur në vlerën e saktë, pasi ato nuk përfshijnë llogaritë e arkëtueshme nga Licencat e veprimtarisë së bizneseve.

(SNISA 400: Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes)

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Adresimi i plotë i rekomandimeve të auditimit vazhdon të mbetet sfida për Menaxhmentin e komunës. Edhe pse janë ndërmarrë veprime, zbatimi i rekomandimeve tona për vitin 2012 është vetëm i pjesërishtëm.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF të vitit 2011 ka rezultuar me 11 (njëmbëdhjetë) rekomandime kryesore. Menaxhmenti i Komunës ka përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se të gjitha rekomandimet do të adresohen.

Në fund të auditimit 5 (pesë) rekomandime janë adresuar plotësisht, 3 (tri) janë adresuar pjesërisht apo janë në proces të adresimit dhe 3 (tri) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II në fund të këtij raporti.

2. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Ne i pranojmë përpjekjet e bëra nga Komuna e Prishtinës për t'i adresuar rekomandimet tona për 2011. Megjithatë, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit paraprak janë implementuar tërësisht, ndërsa të tjerat janë në proces të adresimit, e disa nuk janë adresuar fare.

Rreziku Mosadresimi i të gjitha rekomandimeve të vitit paraprak e shton rrezikun e vazhdimit të dobësive – për shembull të prodhimit të PVF-ve dhe pagesave, si dhe vazhdimin e përdorimit joefektiv të burimeve të NJAB-së.

Rekomandimi 2 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve të ZAP-it me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga Menaxhmenti për të siguruar një menaxhim financiar dhe kontrolle efektive. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund të jetë, për shembull, aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga Menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më të ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të përcaktuara nga Kryetari.

Ne gjithashtu e konsiderojmë vetë-vlerësimin e bërë nga Kryetari i Komunës sipas kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrolleve. Si një proces në vazhdim, presim që Menaxhmenti t'i japë më shumë rëndësi kësaj në vitin 2013 dhe ne do ta shqyrtojmë këtë më në detaje gjatë auditimit tonë të vitit 2013.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Përderisa ekzekutimi i përgjithshëm i buxheti është 74%, kjo reflekton problem në veçanti me ekzekutimin e buxhetit për investimeve kapitale, ku buxhetit është shpenzuar vetëm 56%. Në fushat tjera niveli i ekzekutimit të buxhetit është i kënaqshëm dhe i mirë në krahasim me komunat tjera.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për Komunën e Prishtinës, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Burimet e Fondeve	61,741,684	77,908,168	57,694,113	58,474,706	48,001,630
Granti qeveritar-Buxheti	39,989,495	40,024,395	39,843,922	39,792,761	32,721,714
Të bartura nga viti paraprak -		15,941,908 ²	8,354,450	10,495,189	8,231,842
Të hyrat vetjake	21,752,189	21,752,189 ³	9,335,688	7,965,460	7,044,793
Donacionet Vendore		128,759	102,365	145,182	3,281
Donacionet e Jashtme		60,917	57,688	76,114	

Buxheti Final ndryshon nga Buxheti Fillestar për 16,166,484€. Ky ndryshim është për arsye të bartjes së të hyrave vetjake nga viti i kaluar, në shumë prej 15,941,908€, rritjes së buxhetit me rishikim për 34,900€ për pagat e arsimit, donacioneve vendore në shumën prej 128,759€ dhe granteve të papërcaktuara të donatorëve të jashtëm në shumë prej 60,917€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	61,741,684	77,908,168	57,694,113	58,474,706	48,001,630
Paga dhe Mëditjet	21,416,699	22,052,871	22,048,920	21,208,663	16,534,009
Mallra dhe Shërbime	5,438,258	7,379,449	7,136,850	6,055,872	5,154,749
Komunali	1,916,074	1,603,074	1,548,000	1,935,228	2,100,660
Subvencione dhe Transfere	600,000	1,414,597	1,407,690	1,646,490	1,035,950
Investime Kapitale	32,370,653	45,458,177	25,552,653	27,628,453	23,176,262

Veçanërisht i ultë ishte ekzekutimi i buxhetit për Investime kapitale, i cili ishte vetëm 56% dhe derisa ka arsye për këtë, është e qartë që shpenzimet e planifikuara substancialisht i

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat e bartura nga viti i kaluar

³ Të hyrat komunale të planifikuara në vitin 2012

tejkalojnë ato të arritura në vitet paraprake, gjë që madje mundëson që zotimet potenciale që ekzistojnë nuk janë regjistruar në mënyrë formale (shih edhe seksionin 4.6). Si rezultat i nën-shpenzimit, Komuna kishte një tepricë buxheti prej 20,214,055€.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të mbledhura - rezultati kundrejt buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Pranimi	2011 Pranimi	2010 Pranimi
Të hyrat vetjake	21,752,189	21,752,189	23,160,238	18,906,402	18,747,276

Siç shihet nga tabela të hyrat prej vitit në vit kanë shënuar rritje. Plani i arkëtimit të të hyrave ishte tejkualuar për 1,408,049€ apo në përqindje 6.5% mbi plan. Në krahasim me vitin paraprak, të hyrat ishin për 4,253,836€ apo 22.5% më të larta. Niveli faktik i të arkëtueshmeve të faturuara në vitin 2012 ishte 38,803,000€ dhe Komuna kishte bërë disa supozime të rëndësishme mbi nivelet e mbledhjes në vitin 2012. Këto janë diskutuar më shumë në seksionin 4.6.1.

3. Çështja - Ekzekutimi i buxhetit në Investimet Kapitale - Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** Niveli i ekzekutimit të buxhetit për Investime Kapitale është i ulët siç është shpejguar në komentet në lidhje me Tabelën 2.
- Rreziku** Ekzekutimi i ultë i buxhetit do të rezultojë me shfrytëzim jo efikas të burimeve nëpër tërë sektorin publik dhe e redukton efektivitetin e planeve të shpenzimeve në organizatat buxhetore.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komunës duhet që në mënyrë sistematike t'i vlerësojë arsyet për nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit që ka të bëjë me Investimet Kapitale në vitin 2012 dhe t'i përcaktojë opsionet praktike për përmirësimin e shpenzimeve përgjatë tërë vitit. Kjo mund të përfshijë një analizë dhe vlerësim kritik mbi planifikimin e detajur me specifikacione të qarta të projekteve kapitale duke marr parasyshë edhe mundësitë dhe pengesat që mund të dalin gjatë realizimit të tyre

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna e Prishtinës i ka përmbushur kërkesat e raportimit që dalin nga legjislacioni në fuqi dhe iu ka përmbajtur afateve të kërkuara kohore.

Përshkrim

Komuna e Prishtinës i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e projekteve kapitale në Ministrinë e Financave.
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet operacionale (të performancës);
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet mbi obligimet ndaj furnitorëve të dorëzuara në MF;
- Raportet mbi kontrollet e brendshme, përfshirë edhe raportin e vetëvlerësimit;

Plani i Veprimit për implementimin e rekomandimeve.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Komuna e Prishtinës me sukses ka rritur nivelin e arkëtimit dhe në vitin 2012 e ka tejkaluar buxhetin. Megjithatë, sfidë serioze mbetet mbledhja e borxheve të vjetra, të mbetura nga vitet paraprake nga tatimi në pronë, lejet e bizneseve dhe të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i pronave komunale. Zhvillime të ngjashme kërkojnë në lidhje me legalizimin dhe pranimin teknik të ndërtimeve.

Përshkrimi

Të hyrat vetjake paraqesin një burim të rëndësishëm të fondeve buxhetore të Komunës së Prishtinës duke financuar 1/3 të shpenzimeve në vitin 2012. Komuna në vitin 2012 kishte arkëtuar 23,160,238€ apo 6.5% mbi planin. Elementet më të rëndësishme të të hyrave janë Taksa për leje të ndërtimit dhe legalizim (58%), Tatimi në pronë (16%) taksat administrative (10%), etj.

4. Çështja - Tatimi në pronë - Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Komuna nga tatimi në pronë për vitin 2012 kishte pritur të arkëtojë 4,400,000€ - duke përfshirë edhe borxhet e së kaluarës -, ndërsa kishte arkëtuar 3,854,074€, apo 12% më pak nga plani. Përderisa niveli i arkëtimit ofron të hyra të rëndësishme, Komuna nuk kishte hartuar ndonjë plan gjithëpërfshirës apo strategji se si t'i inkasojë borxhet e vjetra.
- Rreziku** Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikojë në mundësinë e Komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve dhe poashtu mund të rezultojë në vështirësi të mëtutjeshme në arkëtimin e të hyrave të ngarkuara.
- Rekomandimi 4** Kryetari i Komunës duhet t'i rishikojë procedurat ekzistuese në mbledhjen e tatimit në pronë dhe t'i shqyrtojë dhe t'i zbatojë opsionet për rritjen e shkallës së mbledhjes duke përfshirë edhe aplikimin e mjeteve ligjore aty ku është e përshtatshme.

5. Çështja - Lejet e ndërtimit - Prioriteti - i rëndësishëm

- E gjetura** Komuna, nga lejet e ndërtimit për periudhën e vitit 2012 kishte mbledhur 13,856,426€. Ne kemi identifikuar një rast ku mungonte Vendimi për leje ndërtimore si dhe leja urbanistike, ndërsa objekti veç ishte në përfundim e sipër. Mbeten probleme zhvillimi i planeve rregullative, identifikimi i ndërtimeve pa leje dhe të siguruarit që pranimi teknik/legalizimi i ndërtesave është arritur në një mënyrë të strukturuar dhe me kohë.
- Rreziku** Një proces joefektiv për monitorimin e ndërtimeve do të rezultojë në mos ngarkimin me taksën për leje të ndërtimeve/tarifave të legalizimit dhe me ndërtesa që nuk i përmbushin specifikat e kërkuara. Kjo mund të rezultojë në humbje financiare për Komunën si dhe do të rezultojë ndikime negative për mjedisin.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet t'i rishikojë procedurat dhe kontrollet ekzistuese me qëllim të sigurimit të një shqyrtimi efektiv të ndërtimeve. Kjo duhet të përfshijë mekanizma për identifikimin e ndërtimeve pa leje, monitorim efektiv të ndërtesave gjatë fazës së ndërtimit për të siguruar që i kanë të bashkëngjitura lejet e ndërtimit dhe të përfshijë mjete ligjore dhe të tjera për adresimin e aktivitetit që nuk është në harmoni dhe vonesat në ekzekutim.

6. Çështja - Taksa për veprimtari biznesore - Prioritet - i rëndësishëm

- E gjetura** Bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale nr. 03/L049, kërkohet që çdo biznes të pajset me leje për zhvillimin e veprimtarisë. Gjatë vitit 2012, Komuna kishte mbledhur 293,253€, ndërkaq në vitin 2011 arkëtoi 450,984€. Kjo lloj takse është hequr, por për vitin 2012 duhet konfirmuar se janë lëshuar faturat e duhura pasi që baza e të dhënave të bizneseve nuk është e vendosur Borxhi i mbetur i bizneseve nuk është shpalosur në pasqyrat financiare.
- Rreziku** Identifikimi jo i plotë i shumave faktike të ngarkuara për biznese mund të rezultojë në dështim për të ngarkuar fatura të mjaftueshme dhe në nëndeklarim të informatave relevante në PVF. Mbledhja jo e plotë e të hyrave mund të ndikojë në realizimin e shpenzimeve të planfikuara.
- Rekomandimi 6** Kryetari i Komunës duhet të shtoj mbikqyrjen qendrore për taksën e biznesit dhe të forcoj masat në arkëtimin e borxheve të mbetura nga kjo lloj takse duke identifikuar qartë ato si të arkëtueshme të pa realizueshme aty ku ekzistojnë si dhe t'i shpalosë në PVF.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Në përgjithësi, Komuna ka vendosur kontrole të duhura për procedurat e prokurimit dhe pagesave e shpenzimeve tjera. Megjithatë, kontrollet në lidhje me menaxhimin e kontratave nuk kanë funksionuar si duhet dhe në këtë fushë kërkohen përmirësime domethënëse.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Blerjet e realizuara dhe paguara nëpërmjet procedurave të prokurimit për vitin 2012 ishin në vlerë prej 31,339,031€. Këtu përfshihen investimet kapitale dhe mallrat dhe shërbimet, duke përjashtuar shpenzimet komunale, për të cilat nuk zhvillohen procedurat e prokurimit.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim gjatë vitit lidhur me projektet e parapara.

Të gjeturat dhe rekomandimet

7. Çështja - Kontestet kontraktuale të dalura si rezultat i përgatitjes të projektit - Prioriteti - I rëndësishëm

- E gjetura** “Asfaltimi i segmentit të rrugës Unaza qendrore-pjesa perëndimore” në vlerë prej 490,913€, e filluar më 31.08.2012, puna është ndaluar pas 18 ditësh pune, për shkak të një kontesti pronësor me Ndërmarrjen e Hekurudhave të Kosovës. Sipas menaxherit të projektit dhe organit mbikëqyrës, vlera e punës së kryer është 200,000€ dhe kjo shumë është paguar.
- Rreziku** Planifikimi i dobët i prjekteve duke mos i adresuar kërkesat relevante mund të rezultojë në humbje financiare, duke përfshirë këtu edhe koston indirekte të përgatitjeve të bartur nga departamentet komunale. Projektet e ndalura mund të rezultojnë në kosto shtesë për shkak të çështjeve të dalura para rifillimit të kontratës.
- Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet ta shqyrtojë projektin e unazës qendrore për të përcaktuar pse çështjet e shoqëruara me pronësinë nuk janë identifikuar në fazën e planifikimit të projektit. Duhet t’i rishikojë procedurat planifikuese ekzistuese të projektit për t’i shtuar kontrollet për t’u siguruar që çështja e njëjtë të mos ndodhë në të ardhmen.

8. Çështja - Mos fillimi i kryerjes së punëve me kohë dhe vonesa në ekzekutimin e punëve - Prioriteti- I rëndësishëm

E gjetura Në një numër kontratash ka pasur vonesa të konsiderueshme në kryerjen e tyre.

“Rindërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në lagjen Mat-Grupi II” në vlerë 499,552€, projekti 90 ditësh ka filluar me 31 gusht 2012 dhe është ndërprerë më 4 dhjetor 2012, pas ditës së 70-të. Deri në këtë ditë punimet ishin kryer vetëm në vlerë 100,000€ dhe projekti është ende në vazhdim.

“Rregullimi i oborrit të QMF nr IV Prishtinë” në vlerë prej 68,057€ punimet nuk kishin filluar siç është kërkuar. Gjatë muajit tetor dhe nëntor ishte punuar vetëm shtatë ditë. Deri në kohën e auditimit (22 shkurt 2013) punimet ende nuk ishin kryer. Komuna nuk ka ndërmarrë masa për përfundimin e projektit ose ndërprerjen e kontratës ndaj operatorit ekonomik.

“Renovimi dhe konservimi i hamamit të madh në Prishtinë-Faza III” në vlerë 419,223€ punimet janë ndërprerë, sipas ditarit të punës në ditën e 156, pas vërejtjeve të Institutit për mbrojtjen e monumenteve se projekti dhe materiali i përdorur nuk është adekuat.

Rreziku Projektet e ndalura brenda kohëzgjatjes së pritur mund të rezultojnë me kosto shtesë për shkak të çështjeve të dalura para rifillimit të kontratës. Vonesat në kryerje të projektit apo ndaljet do ta zvogëlojnë përfitimin e qytetarëve nga projekti dhe do të shkaktoj kosto shtesë financiare për Komunën.

Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës duhet t’i rishikojë projektet e identifikuar nga ZAP dhe ta përcaktojë nivelin e monitorimit të ndërmarrë të kontratave dhe veprimet e marra kundër OE-ve për të siguruar kryerjen apo për ta adresuar punën e cilësisë së dobët. Aty ku është e nevojshme procedurat e monitorimit të kontratave duhet të shtohen për të siguruar që janë marrë veprime me kohë për adresimin e mangësive të kontratës. Klauzolat e ndëshkimeve në kontratë duhet të vendosen aty ku është relevante. Theks i veçantë duhet të vendoset në cilësinë e specifikave të përcaktuara në kontrata për t’u siguruar që pritjet për Komunën edhe Operatorin Ekonomik janë të qarta.

9. Çështja - Mos sigurimi i ekzekutimit të kontratës deri në përfundim të projektit - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Për tetë kontrata nuk është vazhduar sigurimi i ekzekutimit të kontratës për kohën sa do të zgjas kryerja e të gjitha punimeve sipas kontratës. Këto kontrata janë:

- (a) Rindërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në lagjen Mat-Grupi II në vlerë 499,525€; (b) Restaurimi dhe konservimi i hamamit të madh në Prishtinë në vlerë 419,224€; (c) Meremetimi i shkollës së vjetër në Mat-adaptimi në institucion parashkollor në vlerë 111,055€; (d) Rregullimi i oborrit të QMF nr IV Prishtinë në vlerë 68,057€; (e) Ndërtimi i dy mbikalimeve të shkollës së mesme e mjekësisë dhe shkollës në Arbëri në vlerë 327,777€; (f) Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugën mbi lumin "Prishtina" në Kalabri në vlerë 146,293€; (g) Rindërtimi i rrugës lidhëse në Hajvali dhe Mramor në vlerë 180,144€; dhe (h) Ndërtimi i rrugës mbi kolektorin atmosferik të lumit "Prishtina" në lagjen Kalabria në vlerë 847,121€.

Garancionet bankare për këto projekte ishin vazhduar gjatë vitit 2013 dhe janë sjellur edhe dëshmitë lidhur me to (para finalizimit të raportit).

Rreziku Kontratat pa mbulesë nga një garancion valid bankar mund të rezultojnë në humbje financiare për Komunën pasi nuk ka mjete ligjore në dispozicion për të adresuar çështjet e cilësisë që kanë të bëjnë me kontratat.

Rekomandimi 9 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë garancione bankare valide për të gjitha kontratat relevante dhe ato ta mbulojnë tërë periudhën e ekzekutimit të punimeve deri në praninë teknike.

10. Çështja - Klasifikimi i shpenzimeve në kategori ekonomike jo adekuate –Prioriteti - Tjetër

- E gjetura** Ne kemi vërejtur se në pesë raste komuna kishte bërë klasifikimin e shpenzimeve në kode të gabuara. Shpenzimet për trajnime të personelit ishin klasifikuar me kod ekonomik 31900 si kapitale tjera, ndërsa është dashur të regjistrohen si mallra dhe shërbime (17,866€). Dy pagesa për subvencionimet për bletë dhe pajisje bletare për përfituesit individualë ishin klasifikuar si kapital tjetër në kuadër të investimeve kapitale (47,120€).
- Rreziku** Regjistrimi i gabueshëm i shpenzimeve zvogëlon efektivitetin e mekanizmave të kontrolleve buxhetore dhe mund të ndikojë në procesin e vendimarrjes së menaxhmentit. .
- Rekomandimi 10** Kryetari i Komunës duhet të siguroj regjistrim korrekt të shpenzimeve dhe të sigurojë që është bërë një nivel i duhur i shqyrtimit nga menaxhmenti për ta mbështetur këtë.

4.5.2 Shpenzimet Tjera

Përshkrim

Blerjet tjera janë ato blerjet të cilat nuk i nënshtrohen procesit të prokurimit. Këto mund të përfshijnë shpenzimet komunale, shpenzimet e udhëtimit, shpenzimet e përfaqësimit etj.

Në këtë fushë nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për të raportuar.

4.5.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payroll). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga Komuna përfshijnë a) autorizimin e listës së pagave b) verifikimin e ndryshimeve t, c) monitorimi i buxhetit dhe barazimet me thesarin.

Të gjeturat dhe rekomandimet

11. Çështja - Mos ruajtja e dokumentacionit të rekrutimit të stafit – Prioriteti – Tjetër

E gjetura Bazuar në Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në shërbimin civil neni 23 i kësaj rregullore përcakton mbajtjen e një Regjistri të aplikacioneve të pranuar nga njësisia e personelit dhe ruajtja e tyre .

Rekrutimi i një Zyrtari të lartë për prodhimtari bimore në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Prishtinës është anuluar dy herë para se të rekrutohet një zyrtar për herën e tretë. Nuk është ruajtur asnjë dokument që i shpjegon këto vendime me arsyetimin se kishte mungesë të hapësirës për ruajtje. Poashtu, e kemi identifikuar që një numër i dosjeve të stafit nuk kanë qenë të plota, ku mungonin: aplikacioni për punë, vlerësimi i të punësuarit, përshkrimi i punës dhe letër identifikimi.

Rreziku Mos ruajtja e dokumentacionit, rritë rrezikun për të ndodhur parregullsi në rekrutime dhe në ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit në përputhje me kërkesat e caktuara ligjore. Mungesa e dokumenteve kyçe do ta ndalojë aktivitetin efektiv të sektorit të burimeve njerëzore në fushat si psh. vlerësimi i stafit.

Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës duhet ta forcojë kontrollin e brendshëm në Administratën e Komunës duke i qartësuar kërkesat për ruajtje të dokumenteve dhe duke siguruar që opsionet adekuate për ruajtjen e tyre janë zbatuar - duke përfshirë këtu edhe mundësinë e ruajtjes elektronike. Kontrollat e mbikëqyrjes duhet të aplikohen për ta siguruar plotësinë e mbajtjes së informatave të kërkuara. Komuna duhet të nxjerrë një rregullore të brendshme për ruajtjen dhe klasifikimin e dokumenteve bazuar në Ligjin për Arkivat Shtetërore nr. 04-L-088-2012 neni 17.

4.5.4 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Subvencionet ndahen kryesisht për entitete publike dhe entitete jo publike (individë), si bursa për studentë dhe nxënës, subvencione për sport, ndihmë me ndërtime të shtëpive në emër të gjendjes së rëndë ekonomike, ndihma në ushqim për rastet emergjente dhe ndihma tjera sociale, subvencione në bujqësi, etj.

Të gjeturat dhe rekomandimet

12. Çështja - Baza e pa mjaftueshme ligjore e dhënies së subvencioneve - Prioriteti - Tjetër

E gjetura Komuna nuk ka pasur një rregullore formale që e përcakton bazën për alokimin e subvencioneve. Megjithatë, një rregullore është aprovuar në Kuvendin Komunal në fund të vitit, duke ndjekur rekomandimin tonë në auditimin e ndërmjetëm.

Rreziku Mungesa e një rregulloreje formale në lidhje me subvencionet mund të rezultojë në atë që fondet të mos shfrytëzohen sipas qëllimeve të duhura apo të mos përfundojnë me rezultatet e pritura.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që rregullorja e re në lidhje me subvencionet të zbatohet plotësisht në vitin 2013 dhe të shqyrtohet pas një periudhe gjashtë mujore për të siguruar se ajo i ka sjellur rezultatet e pritura dhe ofron bazë të mirë për monitorim efektiv.

13. Çështja - Mungesa e marrëveshjeve në mbështetje të subvencioneve dhe dobësi në monitorim - Prioriteti- tjetër

E gjetura Komuna në dy raste të subvencionimit nuk kishte nënshkruar marrëveshje me përfituesit Kompaninë publike "Pastrimi" në vlerë 100,000€ dhe "Trafiku Urban", në vlerë 50,000€.

Rreziku Mungesa e një Marrëveshje formale për subvencion rritë rrezikun që subvencionet e dhëna mos ta arrijnë qëllimin e parashikuar dhe të mos arrihet vlera për para.

Rekomandimi 13 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që kur të jepen subvencionet pas zbatimit të rregullores së re, të bëhet një marrëveshje formale e nënshkruar nga komuna dhe përfituesi, e cila e përcakton qartë bazën në të cilën është dhënë shpërblimi dhe të shoqërohet me kërkesa raportuese.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Komuna ka bërë përpjekje domethënëse në regjistrimin e pasurive që nga viti 2011. Menaxhmenti kishte themeluar një komision për vlerësimin e të gjitha pasurive të komunës, sipas kërkesave të UA 21/09 dhe niveli i pasurive mbi dhe nën 1000€ është rritur dukshëm. Megjithatë, mund të bëhen ende përmirësime.

Përshkrim

Komuna e Prishtinës ka përmirësuar në masë të madhe regjistrimin e pasurive. Në vitin 2011 gjendja e pasurive me vlerë mbi 1,000€ ishte 10,450,000€ ndërsa në vitin 2012 ishte 2,467,072,000€. Po ashtu, edhe te pasuritë me vlerë nën 1,000€ janë rritur. Në vitin 2011 pasuritë nën 1000€ ishin zero (0) ndërsa në vitin 2012 ishte 550,000€.

Të gjeturat dhe rekomandimet

14. Çështja - Regjistrimi i stotope - Prioriteti - Tjetër

E gjetura Komuna nuk posedon një regjistër të plotë të të gjitha stotope përfshirë edhe ato të sektorit të arsimit dhe atij të shëndetësisë.

Rreziku Regjistrimi jo i plotë i stotope do të rezultojë në regjistrim të pasaktë të vlerave të pasurisë dhe do ta shtojë rrezikun e humbjes dhe tjetërsimit dhe atë për vendime të dobëta buxhetore në lidhje me stoqet.

Rekomandimi 14 Kryetari i Komunës duhet të miratojë një proces formal në identifikimin dhe vlerësimin e të gjitha stotope në çdo fundvit dhe rezultatet e regjistrimeve t'i krahasojë me ato të regjistrave kontabël. Diferencat duhet të sqarohen.

4.6.1 Trajtimi Llogarive e arkëtueshme

15. Çështja - Trajtimi dhe prezantimi i Llogarive të arkëtueshme -Prioriteti- i rëndësishëm

E gjetura Vlera e përgjithshme e Llogarive të arkëtueshme të prezantuara në PVF të komunës ishte 38,803,000 (duke e përjashtuar taksën për leje të biznesit), Këto i përfshijnë edhe borxhet e së kaluarës, mirëpo nuk ka strategji formale për ta mbledhur shumën e plotë të identifikuar.

Rreziku Mungesa e një strategjie të qëndrueshme për mbledhjen e të gjitha të arkëtueshmeve të ngarkuara mund të ndikojë në arritjen e shpenzimeve të planifikuara dhe sa më shumë që të vjetrohen të arkëtueshmet, aq më vështirë do të jetë për t'i mbledhur ato.

Rekomandimi 15 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se janë hartuar politika dhe mekanizma gjithëpërfshirës për mbledhjen e taksave. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e profilit për vjetërsinë e borxheve dhe një vlerësim praktik se çka prej tyre është e mundur që të mbledhet. Në zhvillimin e planeve për t'i ngritur procedurat e mbledhjes dhe duhet të shqyrtohen veprimet e ndërmarra nga komunat tjera dhe mjetet ligjore që mund t'i mbështesin procedurat e mbledhjes.

4.6.2 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

Komuna ka raportuar obligimet sipas rregullave të thesarit në Ministrinë e Financave dhe ka përmirësuar kontrollat në këtë fushë mbi afatet e pagesës së faturave të pranuar.

Përshkrim

Obligimet e pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2012 ishin në vlerë prej 375,493€. 254,896€ mallra dhe shërbime, 100,045€ për investime kapitale dhe për shërbime komunale janë 20,552€. Këto detyrime nuk janë paguar për shkak të pranimin me vonësë të faturave në vitin 2012. Si edhe te shumë organizata tjera buxhetore, ka edhe obligime tjera të njohura, por udhëzimet e PVF nuk kërkojnë që këto të përfshihen në llogari.

16. Çështja - Prezantimi i obligimeve - Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura

Komuna e Prishtinës i regjistron borxhet në PVF në pajtueshmëri me udhëzimet. Përderisa kjo është e saktë, nuk i jep lexuesit të pasqyrave kuptim të plotë të të gjitha obligimeve aktuale. Gjatë rishikimit analitik nga të dhënat e thesarit për furnitorët e Komunës kemi vërejtur fatura të paguara në vitin 2012, ndërsa faturat ishin të lëshuara në vitin 2011 dhe nuk ishin prezantuar në Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) të vitit 2011.

Shuma totale e Faturave të vitit 2011 të paguara në vitin 2012 ishte 396,005€. Ndërkaq, në (PVF) të vitit 2011 Komuna kishte paraqitur vetëm 71,444€.

Rreziku

Planet e ardhshme të shpenzimeve mund të mos arrihen për shkak të nevojës për t'i paguar zotimet e vitit paraprak. Mos mbajtja e një regjistri të plotë dhe të saktë si dhe mos shpalosja e të gjitha obligimeve rritë rrezikun që faturat të paguhen dy herë.

Rekomandimi 16

Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta mbi regjistrimin dhe pagesën e faturave dhe se bën shpalosjen e tyre të plotë në PVF.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka arritur ta zbatojë planin ambicioz operativ dhe në këtë mënyrë ka ofruar vetëm siguri të kufizuar për menaxhmentin në vitin 2012 mbi operimin efektiv të kontrolleve financiare. Një numër i fushave operative kyçe nuk janë adresuar nga NJAB, mirëpo menaxhmentit ende i mbetet t'i shqyrtojë fushat ku ka pasur rekomandime nga Komiteti i Auditimit.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij, ne e prezantojmë këtu ndaras. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit.

NJAB për vitin 2012 kishte planifikuar për të kryer tetë (8) auditime, dhe kishte arritur që të realizoj vetëm dy (2) auditime, me fushëveprim vitin 2012. Auditimet ishin kryer: (a) në fushën e menaxhimit të pasurive, dhe (b) të hyrat vetjake në drejtorinë e administratës.

17. Çështja - Fokusi i punës së NJAB-së dhe rekomandimet e tyre-Prioriteti - I rëndësishëm

E gjetura Auditimi i brendshëm e ka adresuar vetëm një pjesë të planit të parashikuar dhe nuk i ka përfshirë rreziqet e njohura si ekzekutimin e kontratave të ndërtimeve, të hyrat nga tatimet dhe taksat, proceset e rekrutimeve të stafit dhe procedurat e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme.

Për punën faktike të ndërmarrë, nuk është bërë plan i veprimit nga menaxhmenti për t'i adresuar rekomandimet.

Rreziku Menaxhmenti nuk merr siguri të duhur nga AB mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme që rezultojnë në mos identifikimin e dobësive dhe në vazhdimin e praktikave joefikase që mund të rezultojnë me humbje financiare për Komunën.

Rekomandimi 17 Kryetari i Komunës duhet të punojë me NJAB-në për të zhvilluar një plan të bazuar në rreziqe i cili do të ofrojë siguri gjatë vitit 2013 mbi të gjitha fushat sinjifikante. Aty ku ka pasur rekomandime, Menaxhmenti duhet në mënyrë aktive ta shqyrtojë një plan veprimi të zhvilluar për t'i adresuar rekomandimet e dakorduara brenda një afati kohor relevant..

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm.

Konkluzioni jonë i përgjithshëm në kontekstin e menaxhimit financiar dhe kontrollit është se:

Është bërë një numër i përmirësimeve nga menaxhmenti më 2012 të cilat e kanë shtuar rangun e procedurave dhe proceseve dhe e kanë përmirësuar, për shembull, regjistrimin e pasurive. Megjithatë, mbetet hapësirë për përmirësime për të siguruar që është bërë një aplikim gjithëpërfshirës dhe konsistent i kontrolleve në aktivitetet e Komunës, me theks të veçantë në fushën e menaxhimit të kontratave

PVF të vitit 2012 janë shumë më cilësore se ato një vit më parë. PVF-të janë përgatitur në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”, pos mungesës së informatave mbi stoqet e materialeve shpenzuese në sektorin e arsimit dhe atë të shëndetësisë dhe mbi të arkëueshmet nga taksa e licencës së bizneseve. Këshilla e dhënë në lidhje me pasqyrat nëntëmujore financiare është adresuar nga menaxhmenti. Pos këtyre zërave, informatat e prezantuara në PVF të vitit 2012 janë të plota dhe të sakta dhe janë të shpalosura si duhet.

Adresimi i plotë i rekomandimeve mbetet sfidë për Menaxhmentin e Komunës. Megjithëse janë ndërmarrë veprime, zbatimi i rekomandimeve tona për vitin 2012 është i pjesërishëm..

Përderisa ekzekutimi i përgjithshëm i buxheti është 74%, kjo reflekton problem në veçanti me buxhetin e investimeve kapitale, ku ekzekutimi i buxhetit është 56%. Në fushat tjera niveli i ekzekutimit të buxhetit është i kënaqshëm.

Komuna e Prishtinës ka ngritur nivelin e arkëtimeve dhe në vitin 2012 kishte tejkaluar buxhetin. Megjithatë, mbledhja e borxheve të papaguara nga tatimi në pronë, licencat e biznesit dhe të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i pronës komunale mbeten një sfidë e rëndësishme. Ngashëm, kërkohen zhvillime në lidhje me lejet e ndërtimit dhe proceset e pranimit teknik dhe legalizimin e objekteve të ndërtuara .

Komuna në përgjithësi ka zbatuar kontrolle adekuate për procedurat e prokurimit dhe pagesat e shpenzimeve tjera. Megjithatë, kontrollet në lidhje me menaxhimin e kontratave nuk funksionin si duhet dhe kërkohen përmirësime sinjifikante në këtë fushë

Komuna ka bërë përpjekje të theksuara në regjistrimin e pasurive që nga viti 2011. Menaxhmenti e ka themeluar një komision për vlerësimin e të gjitha pasurive komunale,

siç kërkohet nga UA 21/09 dhe niveli i pasurive të regjistruara mbi dhe nën 1000 € është rritur dukshëm. Megjithatë, ende mund të bëhen përmirësime të mëtutjeshme

Komuna i ka raportuar obligimet në Thesar në pajtueshmëri me rregullat e Ministrisë së Financave dhe i ka përmirësuar kontrollet në fushën mbi afatet kohore të pagesës së faturave të pranuar.

Auditimi i Brendshëm nuk ka mundur ta zbatojë planin ambicioz operativ dhe në këtë mënyrë ka ofruar vetëm siguri të kufizuar për menaxhmentin në vitin 2012, mbi operimin efektiv të kontrolleve financiare. Një numër i fushave operative kyçe nuk janë adresuar nga NJAB, mirëpo menaxhmentit ende i mbetet t'i shqyrtojë fushat ku ka pasur rekomandime nga Komiteti i Auditimit.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht te adresuara	Rekomandimet pjesërisht te adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1. Buxheti	<p>Forcimin e kontrolleve të përgjithshme financiare (administrative, buxhetore dhe menaxheriale) mbi menaxhimin e buxhetit;</p> <p>Se harmonizimet e duhura të alokimeve buxhetore bëhen në pajtim me planet e prokurimit, në veçanti me dinamikën e realizimit të projekteve kapitale; dhe</p> <p>Ecuritë buxhetore përcillen me analiza të kohëpaskohshme dhe në pajtim me gjendjen merren vendime.</p>			X
2. Pasqyrat Vjetore Financiare	Se përgatitja e PVF do të bëhet në pajtim të plotë me kërkesat ligjore, duke përfshirë të gjitha shpalosjet e kërkuara.		PVF ishin përgatitur në pajtim me kërkesat ligjore, me përjashtim të shpalosjeve të kërkuara.	
3. Të hyrat	Barazimet me Thesar dhe në mes drejtorive bëhen dhe mbahen si të tilla nga zyrtari i të hyrave vetanke, përjashtim me ndonjë vonesë		Janë marrë masa për implementim të rekomandimeve sa i përket barazimeve të të	

	<p>apo qeshtje teknike të harmonizimeve;</p> <p>Eshtë instaluar përcjellje më e mirë e garancioneve, duke siguruar pagesat para se ti skadoj afati i vlefshmërisë; dhe</p> <p>Që të ndërmer masa të nevojshme ligjiore për të inkasuar borxhet nga dhënia e tokës me qira dhe pronës tjetër publike.</p>		<p>hyrave.</p> <p>Për menaxhimin më të mirë të Garancioneve për taksat e ndërtimit komuna ka instaluar një program softuerik për përcjelljen e vlefshmërisë së garancioneve.</p> <p>Është azhurnuar lista e shfrytëzuesve të pronës me qira dhe evidentimi i pagesave të tyre, por ende nuk janë marrë masa të duhura për arkëtimin e borxheve.</p>	
4. Prokurimi	<p>Ne rekomandojmë Kryetarin Komunës që të fillojë me masa të menjëhershme në forcimin e proceseve të prokurimit dhe mbikëqyrjes. Për ta bërë këtë, Kryetari i Komunës rekomandohet veçanërisht që të sigurojë se:</p> <p>Asnjë pagesë nuk do të bëhet para se punimet të përfundohen;</p> <p>Pagesat për kontrata ndërtimore do të bëhen në pajtim me shkallën e përmbushjes; dhe</p> <p>Shtimin e kontrolleve në menaxhimin e derivateve.</p>	Po		

5. Shpenzimet	Se të gjitha shpenzimet e ndodhura do të arsyetohen me fatura dhe praktika të tilla duhet të mos përsëriten.	Po		
6. Pagat dhe mëditjet	Që të shtohen kontrollet mbi pagesën e pagave dhe njëherit shuma e paguar më tepër ti kthehet buxhetit.	Po		
7. Pasuritë	Vlerësimin e plotë të pasurisë, objekteve dhe pajisjeve, në mënyrë që të ketë regjistrin përfundimtarë për të gjitha pasuritë që ka nën posedim; Të bëjë ruajtjen, shfrytëzimin dhe mbajtjen nën kontroll të pronës publik	Po		
8. Faturat e papaguara	Se departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta dhe bënë regjistrimin e të gjitha faturave të paguara; Bënë vlerësimin dhe shpalosjen e të gjitha detyrimeve kontingjente.		Detyrimet kontingjente ishin shpalosur si duhet, ndërsa obligimet tjera nuk ishin shpalosur.	
9. Llogaritë e arkëtueshme	Mbajtjen dhe azhurnimin e plotë të llogarive të arkëtueshme, si dhe shpalosjen në PVF.			X
10. Kontrolli i brendshëm	Se do të ndërmerren masa të menjëhershme dhe të qarta për adresimin e të gjitha mangësive të kontrollit të brendshëm, duke	Po		

	<p>nxjerrë udhëzime dhe procedura të qarta në zbatimin rigoroz të kontrolleve aktuale si dhe vendosjen e kontrolleve; dhe</p> <p>Janë marrë masa në ngritjen e vetëdijes tek i gjithë stafi përkatës për qasjet, pritjet dhe kërkesat e mjedisit të kontrollit të brendshëm.</p>			
11.NJAB	<p>Sistemi i auditimit të brendshëm në komunë (NJAB dhe AK) janë ngritur duke përfshirë një marrëdhënie të re dhe koordinim më të mirë në mes të menaxhimit dhe sistemit. Identifikimi I zonave me rreziqet më të mëdha të biznesit është një fushë ku duhet të kontribuojnë të gjithë partnerët në këtë sistem. Duke bërë këtë, prioritet duhet t'i jepet aktiviteteve aktuale, dhe jo proceseve nga vitet e mëparshme.</p>			X